

L I G J
Nr.7869, datë 12.10.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7804, DATË 10.3.1994 “PËR DHOMAT E
TREGTISË DHE TË INDUSTRIËS”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7804, datë 10.3.1994 “Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë”, neni 8 ndryshohet si vijon:

“Sekretari i përgjithshëm i dhomës caktohet nga organi mbikqyrës.”

Neni 2

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Sekretari i përgjithshëm i bashkimit të dhomave caktohet nga organi mbikqyrës.”

Neni 3

Neni 31 ndryshohet si vijon:

“Pasuria shtetërore që ka administruar Dhoma e Tregtisë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, i kalon në përdorim dhomave të tregtisë dhe industrisë që krijohen në bazë të këtij ligji, në masën dhe strukturën që do të përcaktohet nga organi mbikqyrës.

Mënyra e kalimit të pronës të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e

pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit”, si dhe akteve përkatëse nënligjore.”

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.949, datë 25.10.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha